

VENDIM
Nr.577, datë 24.8.2005

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS NR.2, NË MARRËVESHJEN E MENAXHIMIT PËR
SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE NË
ZONËN E SHËRBIMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, SHA, KAVAJË, SHQIPËRI,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR (PUNËDHËNËSI) DHE AQUAMUNDO, GMBH,
KONTRAKTORI MENAXHUES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, dhe të neneve 10, pika 3/I a, e 72, pika 5/I a të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e shtesës nr.2 në marrëveshjen e menaxhimit për sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., Kavajë, Shqipëri, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga organi shtetëror i autorizuar, Ministria e Ekonomisë e Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, dhe Aquamundo, GmbH, kontraktori menaxhues, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Shtesa nr. 2

Për marrëveshjen e menaxhimit e përfunduar më 23 dhjetor 2002

**PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME NË ZONËN E
SHËRBIMIT TË UK KAVAJË SHA
KAVAJË, SHQIPËRI, NDËRMJET QEVERISË SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR (PUNËDHËNËSI) DHE AQUAMUNDO GMBH
(KONTRAKTORI MENAXHUES)**

Sipas kushteve të klauzolës 20, modifikime dhe rinegocime të kësaj Marrëveshjeje, palët e mësipërme të Marrëveshjes së menaxhimit bien dakord reciprokisht për shtesën e mëposhtme:

1. Prezenca e z. Voigt si menaxhues i përgjithshëm i UK Kavaja sh.a. zgjatet me 20.5 muaj, nga 29 prill 2005 deri në datën e përfundimit të marrëveshjes (shiko figurën në aneks).

2. Shtesa aktuale është e vlefshme nga 29 prilli 2005 deri më 28 prill 2007.

3. Kushtet e pagesës: Pagesa bazë për shërbimet brenda kuadrit të shtesës aktuale nr.2, me shumën 342 840 euro (treqind e dyzet e dy mijë e tetëqind e dyzet) euro do të kryhet si më poshtë:

Pagesa tremujore: 11,9% (njëmbëdhjetë presje nëntë për qind) për shtatë (7) pagesa tremujore të ndjekura nga një (1) pagesë prej 16.7% (gjashtëmbëdhjetë presje shtatë për qind ose 57.254,28 euro) në datën e përfundimit të Marrëveshjes, secili nga këto për t'u paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e prezantimit nga ana e kontraktorit menaxhues të raporteve tremujore dhe faturave të kontraktorit menaxhues.

Shuma totale e pagesës bazë përbëhet si më poshtë:

	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
			€	€
Stafi	muaj	20,5	14.900,00	305,450
Dieta ditore	muaj	20,5	780,00	15,990
Banesa	muaj	24	600,00	14.400

Udhëtime ndërkombëtare	Nr.	10	700,00	7,000
Totali				342,840

4. Bihet dakord reciprokisht nga dhe nëpërmjet palëve se shtesa e përmendur më lart nuk ka efekt material në Marrëveshjen origjinale të menaxhimit dhe nuk përbën një ndryshim në përgjegjësitë dhe detyrat e kontraktorit menaxhues.

Në dëshminë e tyre, përfaqësuesit e autorizuar të palëve, kanë nënshkruar këtë shtesë të Marrëveshjes së menaxhimit nr.2, më datë ____/____/2005.